



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit
P- 053
Prishtinë, më 18 dhjetor 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 18 DHJETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 61 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u lajmërua kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, i cili në emër të grupit kërkoi që pika e katërt e rendit të ditës- Projektligji për Presidentin të tërhiqet, me arsyetimin se ky projektligj të procedohet për shqyrtim së bashku me Ligjin për deputetët dhe me Ligjin për Kryeministrin.

Sabri Hamiti tha se nuk ka kurrfarë arsyeje logjike që një ligj, i cili i ka kaluar rregullat procedurale të shqyrtimit në Kuvend, të kushtëzohet me ligje të tjera, që ende nuk janë proceduar në Kuvend.

Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së tha se mbështet kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, tha se pajtohet që ky projektligj të mos procedohet më tutje. Mirëpo, të mos na vijë edhe njëherë i njëjti. Ne, mendojmë se ky projektligj nuk korrespondon me frymën të cilën ne po e ndërtojmë në Kosovë.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se pajtohen me propozimin që ky projektligj të tërhiqet, për vetë faktin se materia e këtij projektligji qysh është pretenduar të adresohet, ka ndryshuar. Edhe sikur sot të votohej për këtë projektligj, ne do të votonim kundër tij.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, tha se pajtohet me mendimin e shumicës së përfaqësuesve të grupeve parlamentare që ky projektligj të shtyhet. Mirëpo, jemi të mendimit që edhe Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit të shqyrtohet sa më parë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit parlamentar të PDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që pika e katërt - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Presidentit e Republikës së Kosovës, të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme.

Kryetari i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, **Esat Brajshori**, shtroi çështjen e emërimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Deputetja **Donika Kadaj-Bujupi** shtroi çështjen e formimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të Agjencisë së Inteligjencës dhe të Këshillit të Sigurisë.

Deputetja **Gjynaze Sylja** kërkoi që Kuvendi, urgjentisht ta udhëzojë Qeverinë për t'i përmbushur përgjegjësitë kushtetuese lidhur me emërimin e komandantit të FSK-së.

Deputeti **Gani Geci** kërkoi që Kuvendi dhe Qeveria të ndikojnë në Agjencinë e Privatizimit për t'ua paguar 20% të mjeteve punëtorëve nga privatizimi i KN “Ramiz Saduku”.

Deputetja **Rita Hajzeraj** kërkoi që Kuvendi, si çështje urgjente, të debatojë në seancën e sotme për shkeljen e sovranitetit shtetëror të Kosovës nga ana e Serbisë.

Kryetari tha se kërkesat e ngritura duhen të procedohet me shkrim.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 4 dhjetor 2008.
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë,
8. Rishqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike, dhe
9. Shqyrtimi Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave Tatimore.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës, të mbajtur më 4 dhjetor 2008.

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 4 dhjetor 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashin, lidhur me problemet e natyrës organizative dhe funksionale në QKUK dhe Fakultetin e Mjekësisë.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Armend Zemaj** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashin, lidhur me numrin dhe trajtimin e pacientëve me sëmundje mendore.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj deputetit Zemaj.

Deputetja **Shpresa Murati** i parashtroi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me shpalljen e Ligjit për RTK-në.

Kryeministri Hashim Thaqi iu përgjigj pyetjes së deputetes Murati

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi pyetje ministrit të Tregtisë, Lutfi Zharku, lidhur me çmimin e naftës në treg.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje Kryeministrit Thaçi apo ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me krimet e bëra ndaj popullit shqiptar gjatë luftës 1998-1999

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Myfera Shinik** parashtroi pyetje për ministrin e Ambientit, Mahir Yagcilar, lidhur me dhënien e lejeve për instalimin e stacioneve bazë në vendbanime dhe përreth.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Shinik.

Deputetja **Drita Maliqi** parashtroi pyetje për ministrin e Arsimit, Enver Hoxhaj, lidhur me prezencën e dukurive negative nëpër shkolla.

Ministri Enver Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputeti **Armend Zemaj** parashtroi pyetje për ministrin e Kulturës, Valton Beqiri, lidhur me projektin ideor për ndërtimin e objektit të Teatrit të Operës dhe Baletit “Ibrahim Rugova”.

Ministri Valton Beqiri iu përgjigj deputetit Zemaj.

Deputeti **Armend Zemaj** parashtroi pyetje për ministrin e Kulturës, Valton Beqiri, lidhur me zhvillimin e politikave rinore.

Ministri Valton Beqiri iu përgjigj deputetit Zemaj

Deputeti **Nait Hasani** parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni lidhur me emërtimin “Kosovar” në pasaportat diplomatike.

Ministri Skender Hyseni iu përgjigj deputetit Hasani.

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtroi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, lidhur me projektin për Parkun Industrial në Korroticë të Drenasit.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Shala.
Me këtë përfundoi koha për pyetje parlamentare.

Kryetari tha se Qeveria e Kosovës ka kërkuar që pika e nëntë të shqyrtohet pas pikës së tretë. Ai kërkoi pëlqimin e deputetëve për kërkesën e Qeverisë. Kuvendi miratoi kërkesën e Qeverisë.

3. Shqyrtimi Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave Tatimore

Kryetari i njoftoi deputetët se Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Administratën tatimore dhe procedurat, ia ka proceduar Kuvendit për miratim listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime, i cili u është dërguar të gjithë deputetëve.

Kryetari kërkoi deklarin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me Propozimi-vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe rekomandimin e komisionit funksional.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, të cilat janë dhënë në transkript, kryetari hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----20,
Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave Tatimore

I. Anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave Tatimore, emërohen:

1. Skender Kolgeci, kryesues,
2. Miftar Shala, anëtar,
3. Ramadan Sejdiu, anëtar,
4. Ekrem Kastrati, anëtar,
5. Osman Sadikaj, anëtar,
6. Luljeta Baraliu, anëtare, dhe
7. Hajrush Beqiri, anëtar.

II. Mandati i anëtarëve të emëruar në Bordin e Pavarur për Rishikimin e Ankesave Tatimore zgjatë dy (2) vjet.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryesuesi i seancës, **Eqrem Kryeziu**, i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit përgjegjës raportues lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional ta arsyetojë raportin.

Deputetja **Flora Brovina** tha se komisioni funksional ka shqyrtuar këtë projektligj dhe pas një debati të gjerë me të gjithë të interesuarit, siç janë: personat me aftësi të kufizuara, shoqatat e tyre, ekspertët, shoqëria civile dhe përfaqësuesit e ministrive kanë dhënë kontribut gjatë shqyrtimit të projektligjit. Në bazë të këtyre debateve, Komisioni ka hartuar amendamente në këtë projektligj dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Ligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryesuesi i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit përgjegjës raportues lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional ta arsyetojë raportin.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni me konsensus të plotë ka hartuar amendamentet, jo vetëm të këtij ligji, por edhe të tri ligjeve të tjera që do t'i shqyrtojmë sot. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryetari hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----23,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Kryetari i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa , si komision përgjegjës raportues, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryetari hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----6,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale

Kryetari i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Deputeti **Ardian Gjini** tha se kjo formë e uljes së taksave në të ardhurat personale është në disavantazh të njerëzve, të cilët kanë të ardhura të ulëta dhe të cilët janë të varfër. Në këtë rast, po privilegjojen ata që kanë të ardhura të mëdha dhe dënohen ata që kanë të ardhura të ulëta.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni me konsensus të plotë ka hartuar amendamentet. Qeveria ka premtuar se në tremujorin e parë të vitit 2009 do t'i procedojë katër projektligje komplete, të cilat rregullojnë këtë fushë.

Ai hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryetari hodhi në votim tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----18,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për tatimin në të ardhurat individuale.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët me raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës raportues, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji.

Ai hodhi në votim, një nga një, amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe 4.

Pastaj, kryetari hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër-----13,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për normën e akcizës në Kosovë.

9. Rishqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike

Kryetari i njoftoi deputetët me Vendimin e Kuvendit, të datës 30 korrik 2008, për procedimin me ligjet e pashpallura. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision përgjegjës raportues, në bazë të vendimit të Kuvendit ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ai hodhi në votim amendamentet e komisionit funksional, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicëvotash miratoi Ligjin për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:30.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale